

VENDIM
Nr. 558, datë 15.7.2026

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RIFORCIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË KURBIN DHE
SHIJAK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjes “i”, të shkronjës “b”, të nenit 13, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 57 478 717, 28 (pesëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë presje njëzet e tetë) lekë pa TVSH, për financimin e riforcimit të banesave individuale për ata individë, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë, që rezultojnë me shkallë dëmi DS4 dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni, në bazë të aktekspertizave të thelluara, në bashkitë Kurbin e Shijak, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Kurbin i transferohet fondi në masën 43 220 255, 28 (dyzet e tre milionë e dyqind e njëzet mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë presje njëzet e tetë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 14 258 462 (katërmëdhjetë milionë e dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, do të përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2026, dhe u transferohet bashkive Kurbin e Shijak në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe bashkitë Kurbin e Shijak për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama